

KLSH DHE AUDITIMI I MENAXHIMIT TË FONDEVE TË BEⁱ

nga Fatos Çoçoli

Me perspektiven e qarte të marrjes nga Shqipëria të statusit të vendit kandidat për në BE brenda këtij viti, si dhe të rritjes së asistencës teknike të Bashkimit Evropian dhe të projekteve me fondet e BE për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit tonë, KLSH po punon të rrisë njohuritë dhe kapacitetet e audituesve të tij për kryerjen e plotë të auditimit të menaxhimit të fondeve të BE. Ky auditim do të shohë menaxhimin e fondeve të akorduara nga BE nga këndvështrimi i efektivitetit të ndihmës së dhënë institucioneve publike përfituese.

Këndvështrimi i BE për auditimin e programeve dhe fondeve të tij

Në periudhën e programimit 2007-2013, Brukseli i ka konsideruar sistemet efektive të kontrollit dhe auditimit të fondeve të BE si një nga çështjet kyçe në zbatimin e politikës së kohezionit të BE. Administratave kombëtare dhe rajonale të vendeve anëtare dhe kandidate për në BE u janë më shumë përgjegjësi dhe janë nxitur për të ndërtuar një sistem efektiv të kontrollit dhe auditimit publik dhe për të siguruar shpenzimin e duhur të parave publike në eksperiencat financiare të mëparshme. Kjo nxitje ka ardhur si për fondet strukturore të BE dhe fondet e kohezionit, ashtu dhe për fondet e Instrumentit të Para-anëtarësimit - IPA. Përveç prezantimit të legjislacionit përkatës, metodat e rritjes së efikasitetit të kontrollit dhe auditimeve sigurojnë dijen e duhur në luftimin dhe parandalimin e mashtrimit financiar, të parregullsive në prokurimet publike dhe në ndihmën shtetërore. BE ofron një përvojë të gjerë të ekspertëve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm që vijnë nga sektori publik, nga Komisioni i BE, si dhe Gjykata Evropiane e Auditorëve dhe Zyra Evropiane Kunder Mashtrimit Financiar (OLAF).

Standardet ndërkombetare në auditimin e fondeve të BE

Komisioni Evropian dhe Gjykata Evropiane e Audituesve me baze ne Strasburg organizojne seminare trajnimi per audituesit edhe te vendeve kandidate apo aspirante per ne BE, ku trajtohen tema si:

-Si mund të përmirësohet cilësia e auditimeve tuaja duke aplikuar standarde te ndryshme te auditimit të brendshëm(te vendit perkates) për auditimin e projekteve të financuara nga BE?

- Cilat janë dallimet në mes të standardeve te auditimit ndërkombëtar?
- Cila është qasja e Komisionit European ndaj auditimit te fondeve te BE?
- Si mund të shmangen gabimet më të shpeshta gjate auditimit te fondeve te BE-së?
- Si realizohet menaxhimi i riskut ne perzgjedhjen fondeve per t'u audituar, sipas standardeve ISA dhe ISSAI?
- Si mund të përputhen kerkesat e auditimit te programeve dhe fondeve te BE me standardet e auditimit?

Përputhja e kerkesave per auditim te fondeve te BE me standardet e auditimit

Perputhja e kerkesave, interesave qe ka Komisioni Evropian si qeveria e BE-se, me interesat dhe kerkesat e vendeve perfituese te fondeve IPA apo fondeve strukturore dhe te kohezionit te BE-se, realizohet duke krijuar edhe ne Shqiperi:

-Nje Autoritet Auditimi, i njohur si nga Brukseli dhe nga qeveria shqiptare. Ai fare mire mund te jete KLSH dhe per kete ka interes te veçante edhe DG-Budget, Drejtoria e Buxhetit e BE-se, qe shoh nje sinergji te madhe ne punen e KLSH me audituesit e brendshem dhe strukturat e tyre.

Kunderpegjigjja e KLSH

Kontrolli i Larte i Shtetit, si strukture kushtetuese dhe e ndergjegjshme per rendesine e rritjes se efektivitetit te projekteve te Bashkimit Evropian ne Shqiperi, eshte gati per te matrre persiper rolin e audituesit te menaxhimit te

fondeve IPA dhe te fondeve strukturore te BE-se, qe do te vijne me fitimin e statusit te vendit kandidat. KLSH synon te rrise kapaciteteve e audituesve të tij nëpërmjet trajnimeve specifike për auditimin e menaxhimit te fondeve te Be-se. Ky trajnim per kete vit dhe per vitin 2014 do te realizohet me eksperte të SIGMA, si dhe nga eksperte të SAI-ve partnere të KLSH, nëpërmjet trajnimeve apo shkëmbimeve të eksperiencës së ngjashme në vendet përfituese të ndihmës së BE-se. KLSH synon po ashtu zgjerimin e marredhenieve me Gjykatën Evropiane te Audituesve, per te mundesuar ne nje te ardhshme te afert auditime te perbashketa me audituesit e kesaj Gjykate. Institucioni shpreson se pas miratimit te ndryshimeve të ligjit organik të KLSH gjate gjysmes se dyte te ketij viti nga Parlamenti i ri, do te mund të realizohet edhe pjesëmarrja e eksperteve të huaj në auditime specifike per fondet e BE-se, te cilat do te kene nje peshe gjithnje e ne rritje ne administrimin e qeverisjes publike ne Shqiperi.

¹ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 23 Korrik, 2013